

VENDIM
Nr.135, datë 3.2.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR NDARJEN E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kriterëve për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, si më poshtë vijon:
 - a) Përparësitë e qeverisë për sektorë dhe zona të ndryshme;
 - b) Numri i popullsisë në secilin qark;
 - c) Niveli i varfërisë sipas qarqeve;
 - ç) Përfitimi i investimeve në 4 (katër) vitet e fundit.
2. Përqindja e kriterëve, në raport me totalin e investimeve, është:
 - a) Përparësitë e qeverisë për sektorë dhe zona të ndryshme, 20%;
 - b) Numri i popullsisë në secilin qark, 25%;
 - c) Niveli i varfërisë sipas qarqeve, 35%;
 - ç) Përfitimi i investimeve në 4 (katër) vitet e fundit, sipas sektorëve përkatës, 20%.
3. Ministria e Financave, në bazë të kriterëve e të peshës së tyre specifike, për ndarjen e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, harton një formulë, të cilën, nëpërmjet një udhëzimi, ua dërgon për zbatim ministrive të linjës, që disponojnë fonde për zhvillimin rajonal.
4. Ministrinë e linjës, në mbështetje të këtyre kriterëve dhe të formulës për shpërndarjen e fondeve ndërmjet qarqeve, bëjnë llogaritjet përkatëse dhe për ndarjen e këtyre fondeve njoftojnë me shkrim Ministrinë e Financave dhe sekretariatit e përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
5. Sekretariatet teknike të ministrive të linjës dhe të institucioneve të tjera i dërgojnë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Financave, dhe sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve listën e projekteve të paraqitura nga njësitë e qeverisjes vendore, të shoqëruar me vlerësimet ekonomiko-teknike.
6. Ministrinë e linjës, për projektet e financuara me grantin konkurrues e të papërfunduara dhe për avancimin e punimeve ende të papaguara, përgatisin një listë, të cilën ia dërgojnë Ministrisë së Financave dhe sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, të paktën dy javë pas mbledhjes së tij të parë.
7. Kriteret e vlerësimit të projekteve, që do të paraqiten për të përfituar nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, ndërmjet njësisë të qeverisjes vendore brenda qarkut, mbi të cilat do të mbështetet komiteti për marrjen e vendimeve janë si më poshtë vijon:
 - a) Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të qarkut dhe në nivel kombëtar;
 - b) Shkalla e ndikimit në reduktimin e varfërisë dhe të rritjes së aksesit në shërbimet bazë;
 - c) Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti;
 - ç) Dhënia e përparësisë, për rrugët dhe infrastrukturën vendore, projekteve ndërkomunale e projekteve të mëdha me ndikim në mbi dy njësi vendore;
 - d) Cilësia e projekteve teknike, të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore;
 - dh) Niveli i mbledhjes së taksave e të tarifave vendore;
 - e) Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve.
8. Sekretariati teknik në Ministrinë e Financave përgatit materialin përmbledhës të listës së projektpropozimeve për çdo qark, të cilin ia dërgon sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, të paktën, dy javë para mbledhjes së tij.
9. Ministria e Brendshme paraqet, pranë sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, përparësitë e zhvillimit, në nivel vendor, në përputhje me strategjitë e zhvillimit të qarqeve.

10. INSTAT-i siguron të gjitha të dhënat e nevojshme për sekretariatit e përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe institucionet e tjera qendrore, të cilat do të shërbejnë për të analizuar projektet e dërguara për financim.

11. Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON), pranë Këshillit të Ministrave, kryen rolin e sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Sekretariati i përgjithshëm administron dhe përgatit materialet, që do të diskutohen nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, duke analizuar projektet e investimeve, në përputhje me përparësitë strategjike kombëtare e të programit politik të qeverisë, si dhe i sugjeron komitetit çështje për vendimmarrje.

12. Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e një udhëzimi për procedurat, që duhet të ndiqen nga ministritë e linjës dhe institucionet e tjera.

13. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, INSTAT-i dhe Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha